



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 48, paragrafit (1), pikës 3) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/21 dhe 74/24) dhe pikës 61) të Vendimit për realizimin e transaksioneve pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 144/24), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

UDHËZIM

për urdhërpagesat në formë letre, pëlqimin për debitimin direkt dhe autorizimin e transmetimit të llogarisë pagesore, listën e shifrave për përshkrimin e pagesave dhe përmbajtjen e fletëpalosjes informative për llogarinë pagesore me funksione bazë

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim përshkruhen:

- urdhërpagesa në formë letre, pëlqimi për debitimin direkt dhe autorizimi i transmetimit të llogarisë pagesore, në lloj të formularëve të dhënë në shtojcë të këtij udhëzimi, si dhe qëllimi i tyre dhe mënyra e plotësimit;
- lista e shifrave për përshkrim të pagesave; dhe
- përmbajtja e fletëpalosjes informative për llogarinë pagesore me funksione bazë.

II. URDHËRPAGESAT ME FORMË LETRE

2. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar t'i përdorin formularët e urdhërpagesave nga shtojcat e këtij udhëzimi në letër gjatë realizimit të transaksioneve pagesore nga vendet fizike të shitjes ku ofrojnë shërbimet, ku:

- printohen në teknikën bardhezi, në dy kopje identike ose në letër vetëkopjuese, nëse plotëson kriterin e transmetimit cilësor të të dhënave të kopjes së destinuar për përdoruesit e shërbimeve të pagesave;
- nuk mund të ndryshojnë renditjen e fushave për elementet e detyrueshme;
- shfaqin titullin e formularit në këndin e sipërm djathtas të dokumentit, me shkronja të theksuara, siç specifikohet në shtojcat;
- logon, markën tregtare dhe selinë e ofruesit pagesor e shfaqin në këndin e sipërm majtas në fushën "Informacione për dhe logon e ofruesit të shërbimeve pagesore" duke përdorur një ngjyrë mbrojtëse dhe pa cenuar qartësinë dhe lexueshmërinë e tekstit në formular;
- në fushat e përcaktuara në mënyrë të duhur, për elementet e detyrueshme, parashihen hapësira të mjaftueshme për futjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për kryerjen e transaksioneve të pagesave në përputhje me Vendimin për realizimin e transaksioneve të pagesave (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi) dhe këtë udhëzim; dhe
- vërtetojnë urdhëresën e plotësuar saktë dhe njëren kopje ia japin përdoruesit të shërbimit pagesor, ndërsa tjetrën e mbajnë për vete.

Formularët e këtij udhëzimi mund të përmbajnë edhe elemente të tjera, përfshirë edhe ato të cilat janë të domosdoshme për plotësimin e kërkesave që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore, të cilat shtohen në fund të formularit përpara fushave të nënshkrimit dhe vendit për vërtetimin e urdhërpagesës.

III. LLOJET E FORMULARËVE, QËLLIMI DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT, LISTA E SHIFRAVE PËR PËRSHKRIMIN E PAGESAVE DHE PËLQIMI PËR DEBITIM DIREKT

3. "Urdhëresë e plotësuar saktë" sipas këtij Udhëzimi është një urdhër në të cilin të gjitha elementet e detyrueshme plotësohen saktë me informacione dhe të dhëna në fushat e formularit dhe konfirmohen me nënshkrimin me dorë të përdoruesit të shërbimit të pagesave.

Urdhëresë për depozitim të parave të gatshme

4. Urdhëresa për depozitim të parave të gatshme është definuar në shtojcën numër 1 të këtij udhëzimi, si formular numër 1 - *Depozitim i parave të gatshme*.

5. Urdhëresa për depozitim të parave të gatshme përdoret për depozitim të parave të gatshme në llogarinë pagesore të ofruesit të shërbimit nga ana e mbajtësit të llogarisë pagesore ose nga një person tjetër i autorizuar nga ai ose me forcën e ligjit.

Urdhëresa e depozitimit të parave të gatshme, nuk mund të përdoret për pagesë në favor të përdoruesve buxhetorë.

6. Elementet e detyrueshme të urdhëresës së depozitimit të parave të gatshme futen në fushat e formularit nga pika 4) e këtij udhëzimi si më poshtë:

- **Emërtimi i depozituesit** - Shënohen emri dhe mbiemri i personit fizik që depoziton para të gatshme nga dokumenti përkatës i vlefshëm për identifikimin e tij personal ose një dokument tjetër i vlefshëm i lëshuar nga organi kompetent shtetëror.
- **Numri i amzës i qytetarit (NAQ) ose numër tjetër për identifikim të depozituesit** - për personat fizik rezident me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shënohet NAQ, ndërsa për ata me vendbanim të përkohshëm, shënohet numri unik i identifikimit nga dokumenti përkatës i vlefshëm i identifikimit, i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për personat fizikë jorezidentë, shënohet numri unik i identifikimit të personit nga dokumenti i vlefshëm personal i identifikimit ose nga një dokument tjetër përkatës i vlefshëm, i lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit të jorezidentit.
- **Numri i dokumentit të identifikimit të depozituesit** – Shënohet numri unik i identifikimit të dokumentit të vlefshëm, me të cilin kryhet identifikimi personal i personit.
- **Sqarime shtesë** – Shënohen të dhëna dhe informacione shtesë nga personi që depoziton para të gatshme për të sqaruar qëllimin e depozitimit, si p.sh., numri i dokumentit, data e blerjes në tregun ditor, numri i palës së kreditit dhe

informacione të tjera shtesë, pra elemente që i referohen dokumenteve zyrtare, duke përdorur shkronja cirilike, shkronja latine dhe/ose numra. Numri maksimal i karaktereve që mund të futen në këtë element është 140, duke përfshirë edhe fushat boshe si karaktere.

- **Përshkrimi i depozitimit** – Shënohet një përshkrim i shkurtër i qëllimit të depozitimit në përputhje me listën e përshkrimeve në shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi ose me aktet nënligjore të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm të këtij udhëzimi: Banka Popullore) me të cilën përshkruhet mënyra e realizimit të transaksioneve pagesore jashtë vendit.
- **Shifra** - Shënohen katër shkronja latine ose një kombinim i katër shkronjave latine dhe numrave ose tre numrave që përfaqësojnë shifrën për përshkrimin e depozitimit në përputhje me shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi ose aktin nënligjor të Bankës Popullore, me të cilin përshkruhet mënyra e kryerja së pagesave të transaksioneve me jashtë. Kur një person fizik depoziton para të gatshme, shënimi i shifrës është detyrim i ofruesit të shërbimit të pagesave, bazuar në të dhënat e ofruara nga depozituesi në elementin e detyrueshëm që ka të bëjë me informacionin nga depozituesi për marrësin. Kur personi fizik gjatë depozitimit të parave të gatshme vepron në emër dhe për llogari të personit juridik, detyrimi për vendosjen e shifrës i takon personit juridik.
- **Nënshkrimi i depozituesit** – nënshkrimi me dorë i personit fizik që depoziton paratë e gatshme në prani të personit zyrtar të ofruesit të shërbimit të pagesave që merr paratë e gatshme, pas verifikimit nga dokumenti i vlefshëm i identifikimit personal se nënshkruesi është personi i përcaktuar si depozitues në dokument. Nëse personi i cili depoziton paratë e gatshme është person i autorizuar, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kuadër, personi fizik i autorizuar që depoziton paratë e gatshme në llogarinë e pagesës së mbajtësit vendos nënshkrimin me shkrim dore. Nënshkrimi vendoset tek ofruesi i shërbimeve të pagesave në prani të personit zyrtar, të autorizuar nga ofruesi i shërbimit të pagesave, i cili merr paratë e gatshme, pasi kryen kontrollën nëpërmjet dokumentit të vlefshëm të identifikimit personal se nënshkruesi është personi i përcaktuar në dokument si personi fizik i autorizuar si nënshkrues i urdhërësës.
- **Emërtim i pranuesit** - Shënohet titulli i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik - pranues, në llogarinë e të cilin depozitohen paratë e gatshme.
- **Llogaria pagesore e pranuesit** - Shenja "MK07", paraqet pjesë fikse të këtij elementi, në vazhdimin e së cilës shënohet numri i llogarisë pagesore të pranuesit.
- **Valutë** - Shënohet kodi i valutës në pajtim me shtojcën 3 të këtij udhëzimi, i cili është objekt i transaksionit të pagesës (me shkronja latine).
- **Shuma** - Shënohet shuma e parave të gatshme e shprehur në valutën në të cilën depozitohet. Shuma shënohet djathtas, pa hapësira, si numër racional me dy shifra decimale. Vendet e zbrazëta plotësohen me shenjën mbrojtëse "yll" (*).
- **Shteti i jorezidentit** - Shënohet emri i shtetit të jorezidentit. Kjo fushë plotësohet kur personi me status jorezident depoziton para të gatshme në llogarinë e tij pagesore, si dhe kur personi me status të rezidentit depoziton para të gatshme në valutë të huaj në llogarinë e tij pagesore të cilën e ka pranuar nga jorezidenti.

Shënimi i këtij elementi është i detyrueshëm. Në rastin e parë, jorezidenti e cakton shtetin rezident, ndërsa në rastin e dytë rezidenti e cakton shtetin jorezidenti nga i cili ka pranuar para të gatshme. Ky element nuk shënohet nëse personi me status të rezidentit ka pranuar para të gatshme nga personi tjetër me status rezident.

- **Data e dorëzimit** - Shënohet data e paraqitjes së urdhëresës. Format i shënimit të datës është sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Vend për të shtuar elemente për verifikimin e urdhëresës** - Shënohen ora dhe minutat e dorëzimit të urdhëresës. Format i shënimit të kohës është sipas renditjes orë dhe minuta (OO:MM). Në këtë pjesë është e obligueshme të vendoset nënshkrimi i personit zyrtar nga ofruesi i shërbimit pagesor. Ofruesi i shërbimit pagesor në urdhëresën mund të shënojë elemente, të cilat do të ndihmojnë për përpunim më të lehtë automatik të urdhëresës nga sistemi i tij informativ.

Urdhëresë për tërheqjen e parave të gatshme

7. Urdhëresa për tërheqje të parave të gatshme, është definuar në shtojcën numër 1 të këtij udhëzim si formular numër 2 - *Tërheqje e parave të gatshme*.

8. Urdhëresa për tërheqje të parave të gatshme përdoret për tërheqjen e parave të gatshme të llogarisë pagesore te ofruesi i shërbimit nga ana e mbajtësi të llogarisë pagesore ose nga një person tjetër i autorizuar nga ai ose me forcën e ligjit.

9. Elementet e detyrueshme të urdhëresës së tërheqjes së parave të gatshme shënohen në fushat e formularit nga pika 7) e këtij udhëzimi, si më poshtë:

- **Emërtimi i mbajtësit të llogarisë pagesore** - Shënohet emri i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik, nga dokumenti i vlefshëm ekzistues për identifikimin e tij personal të lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, i cili është mbajtës i llogarisë pagesore nga e cila tërhiqen paratë e gatshme.
- **Llogaria pagesore e mbajtësit** - Shenja "MK07" paraqet pjesë fikse të këtij elementi, në vazhdimin e së cilës shënohet numri i llogarisë pagesore nga e cila tërhiqen paratë e gatshme.
- **Sqarime shtesë** – Shënohen të dhëna dhe informacione shtesë për sqarimin e qëllimit të tërheqjes së parave të gatshme, si p.sh., numri i urdhërpagesës për rrugë, i kontratës, i vendimit, i shpenzimeve materiale për periudhën në fjalë, dhe informacione të tjera shtesë, gjegjësisht elemente që i referohen dokumenteve zyrtare, duke përdorur shkronja cirilike, shkronja latine dhe/ose numra. Numri maksimal i karaktereve që mund të shënohen në këtë element është 140, duke përfshirë edhe fushat e zbrazëta si karaktere.
- **Përshkrimi i tërheqjes** – Shënohet një përshkrim i shkurtër i qëllimit të tërheqjes së parave të gatshme në përputhje me listën e përshkrimeve në shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi ose me aktin nënligjor të Bankës Popullore me të cilin përshkruhet mënyra e realizimit të transaksioneve pagesore jashtë vendit.
- **Shifra** – Shënohen katër shkronja latine ose një kombinim i katër shkronjave latine dhe numrave ose tre numrave që përfaqësojnë shifrën për përshkrimin e tërheqjes në përputhje me shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi ose aktin nënligjor të Bankës

Popullore që përshkruan mënyrën e kryerjes së transaksioneve të pagesave me jashtë. Kur një person fizik tërheq para të gatshme, shënimi i shifrës është detyrim i ofruesit të shërbimit pagesor, në bazë të të dhënave të ofruara nga ana e mbajtësit të llogarisë pagesore ndaj të cilit drejtohet urdhëresa e tërheqjes së parave të gatshme në elementin e detyrueshëm që i referohet informacionit nga paguesi për pranuesin. Kur personi fizik gjatë tërheqjes së parave të gatshme vepron në emër dhe për llogari të personit juridik, detyrimi për vendosjen e shifrës i takon personit juridik.

- **Data e dorëzimit** - Shënohet data e dorëzimit të urdhëresës. Format i shënimit të datës është sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Nënshkrimi i mbajtësit të llogarisë pagesore** - nënshkrimi me dorë i personit/personave fizikë që kanë të drejtë të disponojnë llogarinë e pagesës nga e cila tërhiqen paratë e gatshme në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, në prani të personit zyrtar të ofruesit të shërbimit pagesor që lëshon paratë e gatshme, pas kontrollimit të dokumentit të vlefshëm për identifikim personal se nënshkruesi është personi i paraqitur në dokument si pranues i parave të gatshme. Nëse personi fizik që ka të drejtë të disponojë me llogarinë pagesore është i ndryshëm nga personi fizik që pranon para të gatshme, personi fizik i cili ka të drejtë të disponojë me llogarinë pagesore nuk është patjetër të jetë i pranishëm në ambientet e ofruesit të shërbimit pagesor gjatë dorëzimit të urdhëresës për tërheqje të parave të gatshme, me ç'rast personi zyrtar i ofruesit të shërbimeve pagesore që i lëshon paratë e gatshme është i obliguar ta krahasojë nënshkrimin e tij të urdhëresës për tërheqjen e parave të gatshme me nënshkrimin e tij që ka qenë i deponuar paraprakisht tek ofruesi i shërbimit pagesor.
- **Emërtimi i pranuesit të parave të gatshme** - Shënohet emri dhe mbiemri i pranuesit të parave të gatshme sipas një dokumenti të vlefshëm për identifikim personal të lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit rezident të personit fizik.
- **Valutë** - Shënohet kodi i valutës në pajtim me shtojcën 3 nga ky udhëzim, i cili është objekt i transaksionit të pagesës (me shkronja latine).
- **Shuma** - Shënohet shuma e transaksionit pagesor, e shprehur në valutën në të cilën depozitohet. Shuma shënohet djathtas, pa hapësira, si numër racional me dy shifra decimale. Vendet e zbrazëta plotësohen me shenjën mbrojtëse "yll" (*).
- **Numri amëz i qytetarit (NAQ) ose numër tjetër për identifikim të pranuesit** - për personat fizik rezident me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shënohet NAQ-i, ndërsa për ata me vendbanim të përkohshëm, shënohet numri unik i identifikimit nga dokumenti përkatës i vlefshëm për identifikim personal i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për personat fizikë jorezidentë shënohet numri unik i identifikimit të personit nga dokumenti i vlefshëm i identifikimit personal ose nga një dokument tjetër përkatës i vlefshëm i lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit të jorezidentit.
- **Numri i dokumentit të identifikimit të pranuesit të parave të gatshme** – Shënohet numri unik i identifikimit nga dokumenti i vlefshëm me të cilin kryhet identifikimi personal i personit.

- **Shteti i jorezidentit** - Shënohet emri i shtetit në të cilën rezidenti person juridik do të përdorë paratë e gatshme. Ky element nuk shënohet nëse paratë e gatshme përdoren në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose kur personi fizik jorezident ose personi fizik rezident është mbajtësi i llogarisë pagesore nga e cila tërhiqen paratë e gatshme.
- **Nënshkrim i pranuesit të parave të gatshme** - Nëse personi fizik i cili do të pranojë paratë e gatshme njëkohësisht është edhe mbajtës i llogarisë pagesore, ky element i urdhëresës nuk shënohet. Shënimi i këtij informacioni nga ana e mbajtësit të llogarisë pagesore nuk paraqet bazë për refuzim të urdhëresës. Nëse personi i cili tërheq paratë e gatshme është person i autorizuar, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, personi fizik i autorizuar që tërheq paratë e gatshme nga llogaria e pagesës së mbajtësit vendos nënshkrimin me shkrim dore. Nënshkrimi vendoset tek ofruesi i shërbimeve të pagesave në prani të personit zyrtar, të autorizuar nga ofruesi i shërbimit të pagesave, i cili dorëzon paratë e gatshme, pasi kontrollon dokumentin e vlefshëm për identifikim personal se nënshkruesi është personi i përcaktuar në dokument si personi fizik i autorizuar për nënshkrimin e urdhëresës.
- **Vend për të shtuar elemente për verifikimin e urdhërpagesës** - Shënohen ora dhe minutat e dorëzimit të urdhëresës. Format i shënimit të kohës është sipas renditjes orë dhe minuta (OO:MM). Në këtë pjesë është e obligueshme të vendoset nënshkrimi i personit zyrtar nga ofruesi i shërbimit pagesor. Ofruesi i shërbimit pagesor në urdhëresën mund të shënojë elemente të destinuara për përpunim më të lehtë automatik të urdhëresës nga sistemi i tij informativ.

Urdhërpagesë për realizimin e transferimit kreditor në denarë

10. Urdhërpagesa për realizimin e transferimit kreditor në denarë është definuar në shtojcën numër 1 të këtij udhëzim si formular numër 3 - *Transferim kreditor në denarë*.

11. Urdhërpagesa për transferimin kreditor në denarë përdoret për transferim të mjeteve pa para të gatshme (për kryerjen e pagesave ose lloj tjetër të transferimit) nga llogaria e pagesës së paguesit në llogarinë e pagesës së pranuesit në bazë të udhëzimeve nga mbajtësi i llogarisë pagesore ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij ose sipas fuqisë së ligjit.

12. Me përdorimin e urdhërpagesës për transfer kredor në denarë, nuk është e mundur të kryhet transferimi kredor në favor të shfrytëzuesve buxhetorë, përfshirë edhe transferimin e mjeteve në denarë kur paguesi dhe/ose pranuesi janë jorezident.

13. Elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për kryerjen e transferimit kreditor në denarë, shënohen në fushat e formularit nga pika 10) e këtij udhëzimi si në vijim:

- **Emërtimi i paguesit** - Shënohet emri i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik, nga dokumenti i vlefshëm ekzistues për identifikimin e tij personal të lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, i cili është mbajtës i llogarisë pagesore nga e cila kërkohet realizimi i transferimit kreditor.
- **Llogaria pagesore e paguesit** - Shenja "MK07" paraqet pjesë fikse të këtij elementi, pas së cilës, në vazhdim, shënohet numri i llogarisë pagesore të paguesit.

- **Sqarime shitesë** – Shënohen të dhëna dhe informacione shitesë nga paguesi për pranuesin me të cilat sqarohet qëllimi i pagesës ose transferimit dhe të cilat janë dakorduar paraprakisht mes paguesit dhe pranuesit, si p.sh., numri i dokumentit, i folios, i fakturës ose marrëveshjes, numrit i palës kreditore dhe informacione tjera shitesë, pra elemente që i referohen dokumenteve zyrtare, duke përdorur shkronja cirilike, shkronja latine dhe/ose numra. Numri maksimal i karaktereve që mund të futen në këtë element është 140, duke përfshirë fushat e zbrazëta si karaktere.
- **Përshkrim i pagesës** - Shënohet përshkrim i shkurtër i qëllimit të pagesës ose transferimit në pajtim me listën e përshkrimeve në shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi.
- **Shifra** - Shënohen katër shkronja latine ose kombinim i katër shkronjave latine dhe numrave që përfaqësojnë shifrën për përshkrimin e transferimit kreditor (pagesës) në pajtim me shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi. Kur paguesi është person fizik, shënimi i shifrës është obligim i ofruesit të shërbimit pagesor, bazuar në të dhënat e dhëna nga depozituesi në elementin e detyrueshëm që ka të bëjë me informacionin nga paguesi për marrësin.
- **Data e dorëzimit** - Shënohet data e dorëzimit të urdhërpagesës. Format i shënimit të datës është sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Nënshkrimi i paguesit** – Nënshkrimi i personit fizik/personave fizikë që ka/kanë të drejtë të disponojë/disponojnë me llogarinë e pagesës nga e cila kryhet transferikreditor, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, identiteti i të cilit përcaktohet në bazë të dokumentit të vlefshëm për identifikim personal, mostrës së nënshkrimeve të depozituara të personave që veprojnë në emër dhe për llogari të tij ose në bazë të elementeve identifikuese të rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe paguesit, të cilat nuk kërkojnë praninë e paguesit në ambientet e ofruesit të shërbimit të pagesave.
- **Emërtim i pranuesit** - Shënohet titulli i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik pranues i mjeteve në bazë të transferit kreditor. Në këtë element të detyrueshëm, me kërkesë të ofruesit të shërbimit të pagesave, mund të shënohet edhe adresa e marrësit, nëse marrësi nuk ka llogari pagese ose produkt tjetër tek ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit.
- **Llogaria pagesore e pranuesit** - Shenja "MK07", paraqet pjesë fikse të këtij elementi dhe në vazhdimin shënohet numri i llogarisë pagesore të pranuesit.
- **Valuta** - Shenja "MKD" paraqet pjesë fikse të këtij elementi në pajtim me shtojcën numër 3 të këtij udhëzimi, i cili e definon valutën e pagesës në denarë.
- **Shuma** - Shënohet shuma e transaksionit pagesor e shprehur në denarë. Shuma shënohet djathtë, pa vende të zbrazëta. Vendet e zbrazëta plotësohen me shenjen mbrojtëse "yll" (*).
- **Emri i sistemit të pagesave** – Shënohet emri i shkurtër i sistemit të pagesave nëpërmjet të cilit paguesi kërkon të kryejë transferimin kreditor, si e dhënë e shkruar me shkronja apo numra cirilike ose latine, i cili është përcaktuar në

Regjistrin e operatorëve të sistemit të pagesave të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- **Data (valuta) e realizimit** - Shënohet data në të cilën ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit duhet të realizojë urdhëresën për transferimin kreditor, i cili plotësohet sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Vend për të shtuar elemente për verifikimin e urdhërpagesës** - Shënohen ora dhe minutat e dorëzimit të urdhëresës. Format i shënimit të kohës është sipas renditjes orë dhe minuta (OO:MM). Në këtë pjesë është e obligueshme të vendoset nënshkrimi i personit zyrtar të autorizuar nga ofruesi i shërbimit pagesor. Ofruesi i shërbimit pagesor në urdhërpagesë mund të shënojë elemente të destinuara për përpunim më të lehtë automatik të urdhëresës nga sistemit i tij informativ.

Urdhërpagesë për realizimin e transferit kreditor jashtë vendit

14. Urdhërpagesa për realizim të transferimit kreditor është definuar në shtojcën numër 1 të këtij udhëzim si formular numër 4 - Transferim kreditor jashtë vendit.

15. Urdhërpagesa për transferin kreditor në denarë përdoret për transferim të mjeteve pa para të gatshme (për kryerjen e pagesave ose lloj tjetër të transferimit) nga llogaria e pagesës së paguesit në llogarinë e pagesës së pranuesit në bazë të instruksioneve nga mbajtësi i llogarisë pagesore ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij ose sipas fuqisë së ligjit.

16. Urdhri i pagesës për transferim kreditor jashtë vendit është i destinuar për kryerjen e transferimit kreditor në valutë të ndryshme nga denari, si dhe në valutë në denarë në rast se transferimi i mjeteve kryhet kur paguesi dhe/ose pranuesi është jorezident.

Me përdorimin e urdhërpagesës për transferim kreditor jashtë vendit, nuk është e mundur të kryhet transferim kreditor në denarë në dobi të shfrytëzuesve buxhetorë.

17. Elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për realizimin e transferit kreditor jashtë vendit shënohen në fushat e formularit nga pika 14) e këtij udhëzimi si në vijim:

- **Emërtimi i paguesit** - Shënohet emri i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik, nga dokumenti i vlefshëm ekzistues për identifikimin e tij personal të lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, i cili është mbajtës i llogarisë pagesore nga e cila kërkohet realizimi i transferit kreditor.
- **Llogaria pagesore e paguesit** - Shenja "MK07" paraqet pjesë fikse të këtij elementi dhe në vazhdim shënohet numri i llogarisë pagesore.
- **Sqarime shtesë** – Shënohen të dhëna dhe informacione shtesë nga paguesi për pranuesin, me të cilat sqarohet qëllimi i pagesës ose transferimit dhe të cilat janë dakorduar paraprakisht mes paguesit dhe pranuesit, si p.sh., numri i dokumentit, faturës ose marrëveshjes, numrit i palës kreditore dhe informacione tjera shtesë, pra elemente që u referohen dokumenteve zyrtare, duke përdorur shkronja cirilike, shkronja latine dhe/ose numra. Në rastin e transaksioneve pagesore të kthyer dhe korrigjimit të gabimeve, paguesi duhet të tregojë arsyen e kthimit, gjegjësisht korrigjimin e gabimit. Numri maksimal i karaktereve që mund të futen në këtë element është 140, duke përfshirë fushat e zbrazëta si karaktere.

- **Përshkrimi i pagesës** – Shënohet një përshkrim i shkurtër i qëllimit të pagesës ose transferimit në pajtim me listën e përshkrimeve të specifikuar në aktin nënligjor të Bankës Popullore, me të cilin përshkruhet mënyra e realizimit të transaksioneve pagesore jashtë vendit. Në rastin e pagesës së detyrimeve mbi shumë baza, ofruesi i shërbimeve pagesore mund të ofrojë formular të përshtatur për shënimin e shumë bazave të pagesës.
- **Shifra** - Shënohen tre numra të cilat paraqesin shifrën për përshkrim të transferit kreditor (pagesës) në përputhje me aktin nënligjor të Bankës Popullore, me të cilin përshkruhet mënyra e realizimit të transaksioneve pagesore jashtë vendit. Në rast të transaksioneve pagesore të kthyer dhe korrigjimit të gabimit, shënohet shifra e njëjtë përkatëse për transaksionin pagesor të të hyrave. Kur paguesi është person fizik, shënimi i shifrës është obligim i ofruesit të shërbimit pagesor, bazuar në të dhënat e dhëna nga paguesi në elementin e detyrueshëm që ka të bëjë me informacionin nga paguesi për marrësin.
- **Statusi i paguesit** - Shënohet shenja "X" në fushën përkatëse, varësisht nga statusi i personit pagues në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rezident ose jorezident.
- **Statusi i pranuesit** - Shënohet shenja "X" në fushën përkatëse, varësisht nga statusi i personit marrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rezident ose jorezident.
- **Data e dorëzimit** - Shënohet data e dorëzimit të urdhërpagesës. Format i shënimit të datës sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Data (valuta) e realizimit** - Shënohet data në të cilën ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit duhet të realizojë urdhërpagesën për transferin kreditor, dhe e njëjta plotësohet sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Nënshkrimi i paguesit** – Nënshkrimi i personit fizik/personave fizikë që ka/kanë të drejtë të disponojë/disponojnë llogarinë e pagesës nga e cila kryhet transferikreditorë, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, identiteti i të cilit përcaktohet në bazë të dokumentit të vlefshëm për identifikim personal, mostrës së nënshkrimeve të depozituara të personave që veprojnë në emër dhe për llogari të tij ose në bazë të elementeve identifikuese të rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe paguesit, të cilat nuk kërkojnë praninë e paguesit në ambientet e ofruesit të shërbimit të pagesave.
- **Emërtim i pranuesit** - Shënohet titulli i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik pranues i mjeteve në bazë të transferit kreditor. Në këtë element, me kërkesë të ofruesit të shërbimit të pagesave, mund të shënohet edhe adresa e marrësit, nëse marrësi nuk ka llogari pagesore ose produkt tjetër tek ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit.
- **Llogaria pagesore e pranuesit** - Shënohet numri i llogarisë pagesore të pranuesit.
- **Valuta** - Shënohet kodi i valutës që është objekt i transaksionit pagesor (me shkronja latine), në pajtim me shtojcën 3 të këtij udhëzimi.

- **Shuma** - Shënohet shuma e transaksionit pagesor, e shprehur në valutën që është objekt i transaksionit pagesor. Shuma shënohet djathtas, pa hapësira, si numër racional me dy shifra decimale. Vendet e zbrazëta plotësohen me shenjën mbrojtëse "yll" (*).
- **Shteti i jorezidentit** - Shënohet emri i shtetit të jorezidentit pagues ose pranues i mjeteve në bazë të transferit kreditor. Nuk shënohet nëse shteti i rezidencës së paguesit dhe pranuesit të mjeteve është Republika e Maqedonisë së Veriut.
- **Emri i sistemit të pagesave** – Shënohet emri i shkurtër i sistemit të pagesave nëpërmjet së cilit paguesi kërkon të kryejë transferin kreditor, si të dhëna me shkronja cirilike ose latine apo numra, i cili është përcaktuar në Regjistrin e operatorëve të sistemit të pagesave të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose të një autoriteti tjetër kompetent jasht vendit, ku është e zbatueshme.
- **BIK-u i ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit** - Shënohet BIK-u (ang. BIC - Business identifier code) i ofruesit të shërbimit pagesor të pranuesit. Nëse transferimi i mjeteve kryhet brenda të njëjtit ofrues të shërbimit të pagesave ose ndaj një ofruesi tjetër shërbimi pagesor në vend, këto të dhëna nuk shënohen. Shënohen 8 deri 11 shenja alfanumerike të cilat korrespondojnë me institucionin financiar, drejt të cilës paguesi ka për qëllim të realizojë transferin kreditor. BIK-u duhet të shënohet sipas ISO-standardit (ang. ISO standard) 9362 dhe më i lartë, për caktimin e institucionit financiar.
- **Tarifa për realizim të urdhërpagesës në ngarkim të:** - Me shënimin e shenjës "X" caktohet se kujt i ngarkohen shpenzimet për realizimin e urdhërpagesës për realizimin e transferit kreditor për transaksionet pagesore jashtë vendit, pra nëse shpenzimet do t'i paguajë paguesi (me zgjedhjen e opsionit OUR), pranuesi (me zgjedhjen e opsionit BEN) ose do të ndahen mes paguesit dhe pranuesit (me zgjedhjen e opsionit SHA).
- **Shenjë tjetër identifikimi e ofruesit të shërbimeve pagesore** - Shënohet në rast kur transferi kreditor realizohet drejt ofruesve të shërbimeve pagesore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose në vende tjera, nëse përdoret shenjë tjetër identifikimi e ndryshme nga BIK-u.
- **Vend për të shtuar elemente për verifikimin e urdhëresës** - Shënohen ora dhe minutat e dorëzimit të urdhëresës. Format i shënimit të kohës është sipas renditjes orë dhe minuta (OO:MM). Në këtë pjesë është e detyrueshme të vendoset nënshkrimi i personit zyrtar nga ofruesi i shërbimit pagesor. Ofruesi i shërbimit pagesor mund të shënojë elemente në urdhërpagesat, të destinuara për përpunim më të lehtë automatik të urdhëresës nga sistemi i tij informativ.

Pëlqim për debitim direkt

18. Pëlqimi për debitim direkt është definuar në shtojcën numër 1 të këtij udhëzimi, si formular numër 5 - *Pëlqim për debitim direkt*.

19. Me pëlqimin për debitim direkt, paguesi jep pëlqim që transaksionet pagesore të caktuara, të inicuar nga pranuesi, të realizohen me debitim direkt te llogaria e tij pagesore tek ofruesi i shërbimit pagesor, nën kushtet e specifikuar në pëlqimin.

20. Pëlqimi për debitim direkt duhet të jetë i plotësuar në mënyrë të duhur të paktën në tre gjedhe. Njërin gjedhe e mban paguesi, tjetra i jepet ofruesit të shërbimit pagesor të paguesit, ndërsa e treta personit pranues të debitimit direkt.

21. Elementet e detyrueshme të pëlqimit për debitim direkt, plotësohen në fushat e formularit nga pika 18) e këtij udhëzimi si më poshtë:

- **Emërtimi dhe adresa e ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit** - Shënohet emri dhe adresa e regjistrimit të personit juridik ofrues i shërbimit pagesor ku paguesi synon të japë pëlqimin për debitim direkt.
- **Shenja unike referuse e pëlqimit** - Shënohet shenja unike referuese identifikuese e pëlqimit të caktuar, nga ana e ofruesit të shërbimit pagesor i cili merr pjesë në skemën e debitimeve direkte, të vendosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtet anëtar i SEPA-s.
- **Emërtimi i paguesit** - Shënohet titulli i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik për të dhënë pëlqim për debitim direkt.
- **Numri i llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose shenjë tjetër unike e identifikimit të paguesit** - Shënohet numri i llogarisë pagesore të pranuesit.
- **Emërtimi i pranuesit** - Shënohet titulli i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik pranues i mjeteve në bazë të debitimit direkt.
- **Shenja unike identifikuese e pranuesit** - Shënohet shenja unike referuese identifikuese e pranuesit e ndarë në bazë të skemës së debitimeve direkte e vendosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtet anëtar i SEPA-s.
- **Kushtet** - Përshkruhen kushtet mbi të cilat paguesi jep pëlqimin për debitimin direkt. Nëse kushtet nuk mund të specifikohen, në këtë fushë, shënohet **"kushte të dorëzuara shtesë"**. Në rast të tillë, paguesi i specifikon kushtet në një dokument shoqërues, i cili paraqet pjesë përbërëse të pëlqimit të dhënë. Ky dokument pa mëdyshje përcakton pëlqimin e debitimit direkt dhe pranuesin e tij, për të cilin vlejné kushtet e përshkruara (shembull: "Kushtet e pëlqimit për debitim direkt në dobi të...").
- Elementi i caktuar sikur: **"Në raportin e llogarisë sime pagesore, shfaqja e transaksionit të debitimit direkt tek ofruesi i shërbimit pagesor duhet të shfaqet si"**, shënohet nga pranuesi i transaksionit pagesor të debitimit direkt, sipas rastit dhe sipas kushteve të parashikuara më parë nga paguesi, tregohet emri i personit juridik, i cili mund të ndryshojë nga ai i regjistruar zyrtarisht, ndërsa në elementin e detyrueshëm "përshkrimi i debitimit direkt" shënohet mënyra e paraqitjes së transaksionit të pagesës në raportin e ofruesit të shërbimit pagesore të paguesit.
- **Nënshkrimi i paguesit, vendi dhe data e dorëzimit të pëlqimit** – Nënshkrimi i personit fizik/personave fizikë që ka/kanë të drejtë të disponoj/disponojnë

llogarinë pagesore, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes kornizë, në prani të personit zyrtar të ofruesit të shërbimit pagesor që kryen kontroll të dokumentit të vlefshëm për identifikim personal se nënshkrues është personi i përcaktuar në dokument si pagues. Gjithashtu, caktohet komuna në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku është dhënë pëlqimi, si dhe data e shënuar sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV) kur është dhënë pëlqimi.

- **Data e fillimit të vlefshmërisë së pëlqimit** - Shënohet data nga e cila synon të fillojë vlefshmëria e pëlqimit. Format i shënimit të datës sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Data e ndalimit të vlefshmërisë së pëlqimit** - Shënohet data nga e cila synon të ndalojë vlefshmëria e pëlqimit. Format i shënimit të datës sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV). Kur ky element nuk shënohet nga ana e paguesit, konsiderohet se pëlqimi është dhënë brenda një viti nga data e përcaktuar në elementin e detyrueshëm si datë e fillimit të vlefshmërisë së pëlqimit. Data e fillimit të vlefshmërisë së pëlqimit dhe data e përfundimit të vlefshmërisë nuk duhet të mbivendosen, d.m.th. data e përfundimit të vlefshmërisë së pëlqimit është gjithmonë më vonë se data e fillimit të vlefshmërisë së pëlqimit.

Urdhërpagesë për debitim direkt

22. Urdhërpagesa për debitim direkt është definuar në shtojcën numër 1 të këtij udhëzimi si formular numër 6 - *Debitim direkt*.

23. Me urdhërpagesën për debitim direkt, pranuesi i pagesës inicon transaksion pagesor për arkëtim nga llogaria pagesore e paguesit në bazë të pëlqimit të siguruar paraprakisht në pajtim me debitimin direkt nga paguesi.

24. Urdhërpagesa për debitim direkt është destinuar për realizimin e debitimit direkt nga llogaria pagesore në denarë.

25. Elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për realizimin e debitimit direkt shënohen në fushat e formularit nga pika 22) e këtij udhëzimi si në vijim:

- **Lloj i debitimit direkt** - Shënohet lloji i debitimit direkt (i përsëritur, një herë, i pari, i fundit ose revokues), siç tregohet në pëlqimin e debitimit direkt të dhënë nga paguesi.
- **Emërtimi i pranuesit** - Shënohet emri i pranuesit të fondeve bazuar në debitimin direkt.
- **Llogaria pagesore e pranuesit** - Shënohet numri i llogarisë pagesore të pranuesit, ku duhet të realizohet debitimi i llogarisë pagesore në bazë të shërbimit të pagesës së debitimit direkt.
- **Shenja unike identifikuese e pranuesit** - Shënohet shenja unike referuese identifikuese e pranuesit e ndarë sipas skemës së debitimeve direkte, e vendosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtet anëtar i SEPA-s.
- **Valuta** - Shënohet kodi i valutës që është objekt i transaksionit pagesor (me shkronja latine), në pajtim me shtojcën 3 të këtij udhëzimi.

- **Shuma** - Shënohet shuma e transaksionit pagesor, e shprehur në valutën që është objekt i transaksionit pagesor. Shuma shënohet djathtë, pa vende të zbrazëta. Vendet e zbrazëta plotësohen me shenjë mbrojtëse "yll" (*).
- **Data e dorëzimit të pëlqimit** - Shënohet data e nënshkrimit të pëlqimit për debitimin direkt nga paguesi. Këto të dhëna janë një element i detyrueshëm, pa të cilin nuk mund të kryhet transaksioni i pagesës. Format i shënimit të datës së nënshkrimit të pëlqimit është sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Data (valuta) e realizimit** - Shënohet data në të cilën ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit duhet të realizojë urdhërpaguesën për debitim direkt, i cili plotësohet sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV). Nëse ky element nuk shënohet, do të konsiderohet se data e realizimit është e njëjtë me datën e dorëzimit.

Nënshkrimi i paguesit – Nënshkrimi me dorë i personit fizik/personave fizikë që ka/kanë të drejtë të inicojë/inicojnë arkëtimin e mjeteve, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, identiteti i të cilit përcaktohet në bazë të dokumentit të vlefshëm për identifikim personal, mostrës së nënshkrimeve të depozituara të personave që veprojnë në emër dhe për llogari të tij ose në bazë të elementeve identifikuese, të rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe pranuesit, të cilat nuk kërkojnë praninë e paguesit në ambientet e ofruesit të shërbimit të pagesave.

- **Data e dorëzimit të urdhërpaguesës** - Shënohet data e dorëzimit të urdhërpaguesës. Format i shënimit të datës sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Emërtimi i paguesit** - Shënohet titulli i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik pagues.
- **Llogaria pagesore e paguesit** - Shënohet numri i llogarisë pagesore të paguesit.
- **Shenja unike referuse e pëlqimit** - Shënohet shenja unike referuese identifikuese e pëlqimit e ndarë nga ofruesi i shërbimit pagesor i cili merr pjesë në skemën e debitimeve direkte e vendosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtet anëtar i SEPA-s.
- **Sqarime shtesë** – Shënohen të dhëna dhe informacione shtesë nga pranuesi për paguesin, me të cilat sqarohet qëllimi i arkëtimin dhe të cilat janë dakorduar paraprakisht mes paguesit dhe pranuesit, si p.sh., numri i dokumentit, faturës ose marrëveshjes, numrit i palës kreditore dhe informacione tjera shtesë, pra elemente që u referohen dokumenteve zyrtare, duke përdorur shkronja cirilike, shkronja latine dhe/ose numra. Numri maksimal i karaktereve që mund të futen në këtë element është 140, duke përfshirë fushat boshe si karaktere.
- **Përshkrim i pagesës** - Shënohet përshkrimi i shkurtër i bazës së transferimit pagesor ose debitimit direkt në pajtim me listën e përshkrimeve në shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi.
- **Shifra** - Shënohen katër shkronja latine ose kombinim i katër shkronjave latine dhe numrave, që përfaqësojnë shifrën për përshkrimin e pagesës në pajtim me

shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi. Kur pranuesi është person fizik, rezident ose person fizik jorezident, vendosja e kodit është detyrim i ofruesit të shërbimit të pagesave, bazuar në të dhënat e dhëna nga pranuesi në elementin e detyrueshëm që i referohet informacionit të pranuesit për paguesin.

- **Vend për të shtuar elemente për verifikimin e urdhërpagesës** - Shënohen ora dhe minutat e dorëzimit të urdhëresës. Format i shënimit të kohës është sipas renditjes orë dhe minuta (OO:MM). Në këtë pjesë është e obligueshme të vendoset nënshkrimi i personit zyrtar të autorizuar nga ofruesi i shërbimit pagesor. Ofruesi i shërbimit pagesor në urdhërpagesë mund të shënojë elemente të destinuara për përpunim më të lehtë automatik të urdhëresës nga sistemi i tij informativ.

Urdhërpagesë për realizimin e transferimit kreditor në favor të shfrytëzuesëve buxhetor

26. Urdhërpagesa për realizimin e transferit kreditor në favor të shfrytëzuesëve buxhetor, është definuar në shtojcën numër 1 të këtij udhëzimi si formular numër 7 - *Transfer kreditor drejt shfrytëzuesit buxhetor*.

27. Urdhërpagesa për transfer kreditor në favor të shfrytëzuesëve buxhetorë, përdoret për transferim të mjeteve pa para të gatshme (për realizimin e pagesave ose lloj tjetër të transferimit) nga llogaria e pagesës së paguesit te llogaria pagesore e pranuesit në bazë të udhëzimeve nga mbajtësi i llogarisë pagesore ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij ose sipas fuqisë së ligjit.

28. Urdhërpagesën për kryerjen e transfereve kreditore në favor të shfrytëzuesëve buxhetorë, institucionet publike shëndetësore mund ta shfrytëzojnë për të hyrë në tregun ditor në denarë në llogarinë pagesore të institucionit publik shëndetësor.

29. Elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për realizimin e transferit kreditor në favor të shfrytëzuesëve buxhetor, plotësohen në fushat e formularit nga pika 26) e këtij udhëzimi si në vijim:

- **Emërtimi i paguesit** - Shënohet emri i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik, nga dokumenti i vlefshëm ekzistues për identifikimin e tij personal të lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, i cili kërkon realizimin e transferimit kreditor.
- **Llogaria pagesore e paguesit** - Shenja "MK07" paraqet pjesë fikse të këtij elementi. Në vazhdim shënohet numri i llogarisë pagesore të paguesit gjatë realizimit të transferit kreditor nga ana e paguesit.
- **Numri tatimor i paguesit** - Shënohet numri unik amzë ose numri unik tatimor i shfrytëzuesit të shërbimit pagesor. Në rast kur detyrimi tatimor paguhet në emër dhe për llogari të personit të ndryshëm nga shfrytëzuesi i llogarisë pagesore, shënohet numri i amzës ose numri unik tatimor i personit në emër të të cilit është detyrimi tatimor - detyrues tatimor. Ky element nuk shënohet kur përdoruesi i llogarisë pagesore është jorezident dhe nuk ka rregulluar qëndrimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- **Sqarime shtesë** – Shënohen të dhëna dhe informacione shtesë nga paguesi për pranuesin, me të cilat sqarohet qëllimi i pagesës ose transferimit dhe të cilat janë

dakorduar paraprakisht mes paguesit dhe pranuesit, si p.sh., numrit të dokumentit, të aktvendimit, datës së qarkullimit pagesor ditor të objekteve shëndetësore publike, periudha e pagesës së tatimit të vlerës së shtuar, numrit të deklaratës doganore dhe informacione tjera shtesë, pra elemente që u referohen dokumenteve zyrtare, duke përdorur shkronja cirilike, shkronja latine dhe/ose numra. Kur bëhet pagesa e kontributeve në favor të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor, element i detyrueshëm është e dhëna numerike për numrin folio. Numri maksimal i karaktereve që mund të futen në këtë element është 140, duke përfshirë fushat boshe si karaktere.

- **Përshkrim i pagesës** - Shënohet përshkrim i shkurtër i pagesës në pajtim me listën e përshkrimeve në shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi.
- **Shifra** - Shënohen katër shkronja latine ose kombinim i katër shkronjave latine dhe numrave që përfaqësojnë shifrën për përshkrimin e pagesës në pajtim me shtojcën numër 2 të këtij udhëzimi. Kur paguesi është person fizik rezident ose person fizik jorezident, vendosja e kodit është detyrim i ofruesit të shërbimit të pagesave, bazuar në të dhënat e dhëna nga paguesi në elementin e detyrueshëm që i referohet informacionit të paguesit për pranuesin.
- **Data e dorëzimit** - Shënohet data e dorëzimit të urdhërpagesës. Format i shënimit të datës sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Data (valuta) e realizimit** - Shënohet data në të cilën ofruesi i shërbimit pagesor të paguesit, duhet të realizojë urdhëresën për transferin kreditor/ remitancës, i cili plotësohet sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV). Nëse ky element nuk shënohet, do të konsiderohet se data e realizimit është e njëjtë me datën e dorëzimit.
- **Nënshkrimi i paguesit** – Nënshkrimi me dorë i personit fizik/personave fizikë që ka/kanë të drejtë të disponojë/disponojnë llogarinë e pagesës nga e cila kryhet transferi kreditor, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, identiteti i të cilit përcaktohet në bazë të dokumentit të vlefshëm për identifikim personal, mostrës së nënshkrimeve të depozituara të personave që veprojnë në emër dhe për llogari të tij ose në bazë të elementeve identifikuese të rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe paguesit, të cilat nuk kërkojnë praninë e paguesit në ambientet e ofruesit të shërbimit të pagesave. Gjatë realizimit të remitancës, shënohet nënshkrim personal i paguesit person fizik, në prani të zyrtarit të ofruesit të shërbimit pagesor, i cili vërteton nga dokumenti i vlefshëm i identifikimit personal se nënshkruesi është personi i caktuar në dokumentin si pagues.
- **Emërtimi i pranuesit** - Shkruhet emri i personit juridik, Thesari i Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Thesari i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë së Veriut.
- **Llogaria pagesore e paguesit** - Shenja "MK07" paraqet pjesë fikse e këtij elementi. Në vazhdim shënohet numri i llogarisë pagesore të Thesarit të Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose llogaria pagesore e Thesarit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- **Shuma** - Shenja "MKD" paraqet pjesë fikse të këtij elementi të detyrueshëm në pajtim me shtojcën 3 të këtij udhëzimi. Në vazhdim shënohet shuma e transaksionit pagesor, e shprehur në denarë. Shuma shënohet djathtë, pa vende të zbrazëta. Pozitat e zbrazëta plotësohen me shenjë mbrojtëse "yll" (*).
- **Llogaria pagesore** - Shënohen të dhënat prej njëmbëdhjetë numrave në pajtim me Udhëzimin për mënyrën e regjistrimit, shpërndarjes, kthimit dhe revokimit të të hyrave publike të përcaktuara nga Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- **Llogaria pagesore e shfrytëzuesit buxhetor** - Shënohen të dhënat prej pesëmbëdhjetë numrave në pajtim me Udhëzimin për mënyrën e operacioneve të thesarit të përcaktuara nga Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- **Shifra e të hyrave dhe programi** - Shënohen të dhënat prej tetë shenjave në pajtim me Udhëzimin për mënyrën e regjistrimit, shpërndarjes, kthimit dhe revokimit të të hyrave dhe Rregullorja për klasifikimin e të hyrave të përcaktuara nga Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- **Emri i sistemit pagesor** – Shënohet emri i shkurtër i sistemit pagesor, nëpërmjet të cilit paguesi kërkon të kryejë transferimin kreditor/remitancë, si dhe të dhëna të shkruara me shkronja cirilike ose latine apo numra, të cilat janë të përcaktuara në Regjistrin e operatorëve të sistemit të pagesave të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- **Vend për të shtuar elemente për verifikimin e urdhërpagesës** - Shënohen ora dhe minutat e dorëzimit të urdhëresës. Format i shënimit të kohës është sipas renditjes orë dhe minuta (OO:MM). Në këtë pjesë është e obligueshme të vendoset nënshkrimi i personit zyrtar të autorizuar nga ofruesi i shërbimit pagesor. Ofruesi i shërbimit pagesor në urdhërpagesë mund të shënojë elemente të destinuara për përpunim më të lehtë automatik të urdhëresës nga sistemi i tij informativ.

Urdhërpagesë kolektive për realizimin e transferimit kreditor në favor të më shumë llogarive pagesore të pranuesit/pranuesve.

30. Urdhërpagesa kolektive për realizimin e transferit kreditor në favor të më shumë llogarive pagesore të pranuesit/pranuesve, është definuar në shtojcën numër 1 në këtij udhëzim si formular numër 8 - *Transferim kreditor kolektiv*.

31. Urdhërpagesa kolektive për realizimin e transferit kreditor në favor të më shumë llogarive pagesore të pranuesit / pranuesve shfrytëzohet kur i ngarkohet një llogarie pagesore të paguesit dhe në favor të më shumë pranuesve, paguhen tarifat e sigurimit të detyrueshëm social, tatimi personal dhe paga neto, pra tatimit personal dhe të hyrat që nuk janë pagë.

32. Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili mundëson këtë shërbim pagesor, i ndërmerr të dhënat elektronike për pagesën e tarifave nga sigurimi i detyrueshëm social, tatimi personal dhe paga neto nga Drejtoria e të Ardhurave Publike.

33. Urdhërpagesa kolektive për realizimin e transferit kreditor në favor të më shumë llogarive pagesore të pranuesit / pranuesve është plotësuar saktë, nëse janë plotësuar

saktë të gjithë urdhërpagesat veçmas, respektivisht është plotësuar me gabim vetëm nëse është i gabuar, qoftë edhe një nga urdhërpagesat individuale të përfshira në të.

34. Urdhërpagesa kolektive për realizimin e transferit kreditor në favor të më shumë llogarive pagesore të pranuesit / pranuesve, me të dhëna kolektive për paguesin printohet në vazhdim të deklaratës për pranim të përlllogaritjes së pagës nga Drejtoria e të Ardhurave Publike. Deklarata për pranim të përlllogaritjes së pagës nga Drejtoria e të Ardhurave Publike e vërtetuar nga zyrtari / zyrtarët e punësuar tek ofruesi i shërbimit pagesor i kthehet paguesit, ndërsa urdhërpagesa mbetet dhe arkivohet tek ofruesi i shërbimit pagesor ku është realizuar trankasioni pagesor.

35. Elementet e detyrueshme të urdhërpagesës kolektive për realizimin e transferit kreditor në favor të më shumë llogarive pagesore të pranuesit / pranuesve plotësohen në fushat e formularit nga pika 30) e këtij udhëzimi si në vijim:

- **Emërtimi i paguesit** - Shënohet emri i personit juridik ose emri dhe mbiemri i personit fizik, nga dokumenti i vlefshëm ekzistues për identifikimin e tij personal, të lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, i cili është mbajtës i llogarisë pagesore nga e cila kërkohet realizimi i transferit kreditor.
- **-Numri tatimor i paguesit** - Shënohet numri i amzës ose numri unik tatimor i shfrytëzuesit të shërbimit pagesor. Në rast kur detyrimi tatimor paguhet në emër dhe për llogari të personit të ndryshëm nga shfrytëzuesi i llogarisë pagesore, shënohet numri amë ose numri unik tatimor i personit në emër të cilit është detyrimi tatimor - detyrues tatimor. Ky element nuk shënohet kur perdoruesi i llogarisë pagesore, është jorezident dhe nuk ka rregulluar qëndrimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- **Sqarime shtesë** - Kjo fushë plotësohet nëse paguesi është shfrytëzues buxhetor, ku detyrimisht shënohet *llogaria përkatëse e shfrytëzuesit buxhetor, llogaria e shpenzimeve dhe programi* nga i cili bëhet pagesa. Nëse paguesi nuk është shfrytëzues buxhetor, sipas nevojës shënohen të dhëna shtesë për pagesën. Ky element përsëritet më shumë herë (varësisht nga numri i urdhërpagesave individuale). Numri maksimal i karaktereve që mund të futen në këtë element është 140, duke përfshirë fushat e zbrazëta si karaktere.
- **Data e dorëzimit** - Shënohet data e dorëzimit të urdhërpagesës. Format i shënimit të datës sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Data (valuta) e realizimit** - Shënohet data në të cilën ofruesi i shërbimit pagesor të duhet të realizojë urdhërpagesën për transfer kreditor, i cili plotësohet sipas renditjes ditë, muaj, vit (DDMMVVVV).
- **Nënshkrimi i paguesit** – Nënshkrimi personal me dorë i personit fizik/personave fizikë që ka/kanë llogari pagesore ose nënshkrim personal me dorë i personit fizik/personave fizikë, të cilët kanë të drejtë të disponojë/disponojnë llogarinë e pagesës nga e cila kryhet transferi kreditor, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, identiteti i të cilit përcaktohet në bazë të dokumentit të vlefshëm për identifikim personal, gjedhen e nënshkrimeve të depozituara të personave që veprojnë në emër dhe për llogari të tij ose në bazë të elementeve identifikuese të rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimit të pagesave dhe

paguesit, të cilat nuk kërkojnë praninë e paguesit në ambientet e ofruesit të shërbimit të pagesave.

- **Llogaria pagesore e paguesit** - Shenja "MK07" paraqet pjesë fikse të këtij elementi. Në vazhdim shënohet numri i llogarisë pagesore të paguesit gjatë realizimit të transferit kreditor kolektiv nga paguesi, i cili do të ngarkohet në llogarinë e tij pagesore dhe në favor të më shumë llogarive pagesore të pranuesve.
- **Shuma** - Shenja "MKD" paraqet pjesë fikse të këtij elementi në pajtim me shtojcën 3 të këtij udhëzimi. Në vazhdim shënohet shuma e transaksionit pagesor, e shprehur në denarë. Shuma shënohet në anën e djathtë të elementit të detyrueshëm, pa hapësira. Vendet e zbrazëta plotësohen me shenjën mbrojtëse "yll" (*).
- **Numri folio** - Paraqet të dhënat nga njëzet e dy numra të cilat gjenerohen nga Drejtoria e të Ardhurave Publike. Numri folio shënohet i rreshtuar nga e majta dhe në vazhdim, sipas nevojës, shënohet informacion shtesë për pranuesin me përshtim të qëllimit dhe bazës së pagesës për të cilën është vendosur urdhëresa. Ky element përsëritet më shumë herë varësisht nga numri i urdhërpaguesave.
- **Emri i sistemit pagesor** – Shënohet emri i shkurtër i sistemit pagesor nëpërmjet të cilit paguesi kërkon të kryejë transferin kreditor, si dhe të dhëna të shkruara me shkronja cirilike ose latine apo numra, të cilat janë të përcaktuara në Regjistrin e operatorëve të sistemit të pagesave të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- **Numri total i urdhërpaguesave** - Në këtë fushë shënohet numri i përgjithshëm i urdhërpaguesave në urdhëresën kolektive.
- **Vend për të shtuar elemente për verifikimin e urdhëresës** - Shënohen ora dhe minutat e dorëzimit të urdhërpaguesës. Format i shënimit të kohës është sipas renditjes orë dhe minuta (OO:MM). Në këtë pjesë është e obligueshme të vendoset nënshkrimi i personit zyrtar të autorizuar nga ofruesi i shërbimit pagesor. Ofruesi i shërbimit pagesor mund të shënojë elemente në urdhëresën të destinuar, për përpunim më të lehtë automatik të urdhërpaguesës nga sistemi i tij informativ.

Urdhërpaguesë për realizimin e remitancës

36. Urdhërpaguesa për realizimin e remitancës përdoret nga paguesi për transferimin e mjeteve të pranuesit pa përdorimin e llogarisë pagesore nga paguesi, pranuesi ose nga të dy.

37. Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore i pranon mjetet nga paguesi në para të gatshme pa hapur llogari pagesore për paguesin ose pranuesin dhe me qëllimin e vetëm për të vënë në dispozicion të marrësit sasinë e duhur të fondeve ose për t'i transferuar ofruesit të shërbimeve pagesore për pranuesin, i cili i vë në dispozicion, mund të hartojë një formular urdhërpaguesë për realizimin e remitancës, në të cilin duhet të specifikohen elementet e detyrueshme në pajtim me pikën 31) të Vendimit.

38. Nëse paguesi, në udhëzimet e dhëna për ofruesin e shërbimeve pagesore i cili i merr fondet për t'i procesuar ato, pra për t'i transferuar shumën e duhur ofruesit të shërbimit

pagesor te pranuesi i cili i vë ato në dispozicion, tregon gjithashtu edhe llogarinë pagesore të pranuesit, e cila është përbërë sipas strukturës BBAN/IBAN, është e detyruar të përdorë ndonjë nga formularet numër 3, 4 ose 7 nga ky udhëzim, përkatësisht. Paguesi i përdor këto formulare kur vë në dispozicion të ofruesit të tij të shërbimeve pagesore para të gatshme që përdoren për të kryer një transferim fondesh në llogarinë pagesore të pranuesit të përpiluar sipas strukturës BBAN/IBAN.

39. Gjatë plotësimit të urdhërpagesës për transferim të parave gjatë përdorimit të formulareve 3,4 dhe 7 të këtij udhëzimi, përveç elementeve të detyrueshme në pajtim me pikën 31) nga Vendimi, përdoruesi i shërbimeve të pagesave shënon edhe elementet tjera të detyrueshme të përfshirë në këto formulare, përveç elementit të detyrueshëm për llogarinë pagesore të paguesit.

IV. AUTORIZIM PËR TRANSFERIMIN E LLOGARISË PAGESORE DHE PËRMBAJTJEN E FLETPALOSJES INFORMATIVE PËR LLOGARINË PAGESORE ME FUNKSIONE BAZË

40. Me kërkesë të përdoruesit të shërbimeve pagesore, ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar t'i japë atij autorizimin për transferimin e llogarisë pagesore, i cili jepet në shtojcën numër 4 të këtij udhëzimi.

Pas futjes së informacioneve dhe të dhënave të nevojshme në autorizimin për transferimin e llogarisë pagesore, personi fizik që ka të drejtë të disponojë llogarinë pagesore që transferohet, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kornizë, vendos në autorizim nënshkrimin me shkrim dore në prani të personit zyrtar të ofruesit të shërbimit pagesor, i cili vërteton nga dokumenti i vlefshëm i identifikimit personal se nënshkruesi është personi i përcaktuar në dokument si mbajtës i llogarisë pagesore ose është një person tjetër i autorizuar prej tij.

Pas kontrollimit të informacioneve dhe të dhënave të shënuara, personi zyrtar i autorizuar nga ofruesi i shërbimit pagesor e nënshkruan autorizimin.

41. Për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për disponueshmërinë e llogarive pagesore me funksione bazë, ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar të hartojë dhe t'ju sigurojë disponueshmëri konsumatorëve te fletpalosja informative për llogarinë pagesore me funksione bazë, siç është përshkruar në shtojcën numër 5 të këtij udhëzimi, në të cilën duhet të fusë të dhënat dhe informacionet për tarifën që i ngarkohen për shfrytëzimin e shërbimeve pagesore nga konsumatorët, përfshirë edhe konsumatorët e të drejtave ligjore.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

42. Dispozitat e kapitujve II dhe III të këtij udhëzimi do të zbatohen nga 1 nëntori 2025.

Autorizimi për transferimin e llogarisë pagesore nga kapitulli IV të këtij udhëzimi do të zbatohen nga 1 dhjetori 2024.

43. Ky udhëzim hyn në fuqi tetë ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

U. nr. 02-36807/1
29 tetor 2024
Shkup

Guvernatorja
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

Shtojca numër 1
Formulari numër 1

Vendi për të shtuar informacion dhe logon e ofruesit të shërbimit pagesor

Urdhëresë
Depozitim i parave të gatshme DP

Emri i depozituesit

--

NAQ ose numër tjetër identifikimi i depozituesit

--

Numri i dokumentit të identifikimit të depozituesit

--

Sqarime shtesë

--

Përshkrimi i depozitimit

Shifra

[illegible]

Nënshkrim i depozituesit

Emri i pranuesit

--

Llogaria pagesore e pranuesit

[illegible]

Valuta

--	--	--

Shuma

[illegible]

Shteti i jorezidentit

--

Data e dorëzimit

--	--	--	--	--	--	--	--

Vendi i vërtetimit të urdhëresës

--

Vendi për të shtuar informacion dhe logon e ofruesit të shërbimit pagesor	Urdhëresë Tërheqje e parave të gatshme TP
Emri i mbajtësit të llogarisë pagesore 	Emri i pranuesit të parave të gatshme
Llogaria pagesore e mbajtësit M K 0 7	Valuta Shuma
Sqarime shitesë 	NAQ ose numër tjetër identifikimi i pranuesit
Përshkrimi i tërheqjes Shifra	Numri i dokumentit të identifikimit të pranuesit të parave të gatshme
Data e dorëzimit 	Shteti i jorezidentit Nënshkrim i pranuesit të parave të gatshme
Nënshkrimi i mbajtësit të llogarisë pagesore 	Vendi i vërtetimit të urdhëresës

Formulari numër 4

Vendi për të shtuar informacion dhe logon e ofruesit të shërbimit pagesor	Urdhërpagesë Transferim kreditor jashtë vendit TKJ
Emri i paguesit 	Emri i pranuesit
Llogaria pagesore e paguesit M K O 7	Llogaria pagesore e pranuesit
Sqarime shtesë 	Valuta Shuma
Përshkrimi i pagesës Shifra 	Shteti i jorezidentit Emri i sistemit pagesor
Statusi i paguesit <input style="width: 40px; height: 40px;" type="checkbox"/> Rezident <input style="width: 40px; height: 40px;" type="checkbox"/> Jorezident	Statusi i pranuesit <input style="width: 40px; height: 40px;" type="checkbox"/> Rezident <input style="width: 40px; height: 40px;" type="checkbox"/> Jorezident
Data e dorëzimit Data (valuta) e realizimit 	ITJ i ofruesit të shërbimeve pagesore të pranuesit Tarifa për realizim të urdhëresës ngarkohet: <input style="width: 40px; height: 40px;" type="checkbox"/> pagues (OUR) <input style="width: 40px; height: 40px;" type="checkbox"/> i ndarë (SHA) <input style="width: 40px; height: 40px;" type="checkbox"/> pranues (BEN)
Nënshkrimi i paguesit 	Vendi i vërtetimit të urdhërpagesës

Formulari numër 5

Vendi për të shtuar informacion dhe logon e ofruesit të shërbimit pagesor	Pëlqim për debitim direkt	
Emri dhe adresa e ofruesit të shërbimeve pagesore të paguesit	Shenja unike referuese e pëlqimit	
Emri i paguesit		
Numri i llogarisë pagesore (IBAN ose BBAN) ose shenjë tjetër unike e identifikimit e paguesit		
Emri i pranuesit	Shenja unike e identifikimit të pranuesit	
Kushtet		
Në raportin nga llogaria ime pagesore, pasqyra e transaksionit për debitim direkt tek ofruesi i shërbimit pagesor mund të paraqitet sikur (plotësohet nga ana e pranuesit):		
Pranues i debitimit direkt	Përshkrim i debitimit direkt	
Nënshkrimi i paguesit, vendi dhe data e dorëzimit të pëlqimit	Data e fillimit të vlefshmërisë së pëlqimit	Data e përfundimit të vlefshmërisë së pëlqimit

Formulari numër 6

Vendi për të shtuar informacion dhe logon e ofruesit të shërbimit pagesor

**Urdhärpagesë
Debitim direkt DD**

Lloj i debitimit direkt

--

Emërtim i pranuesit

--	--

Llogaria pagesore e pranuesit

[illegible]

Shenja unike e identifikimit të pranuesit

--

Valuta

--	--	--

Shuma

Data e dorëzimit të pëlqimit

--	--	--	--	--	--	--	--

Data (valuta) e realizimit

--	--	--	--	--	--	--	--

Nënshkrimi i pranuesit

Data e dorëzimit të urdhërpagesës

--	--	--	--	--	--	--	--	--

Emri i paguesit

--

Llogaria pagesore e paguesit

[illegible]

Shenja unike referuese e pëlqimit

--

Sqarime shtesë

Squamous metaplasia

Përshkrimi i pagesës

Shifra

Personnel: 4 pages		Summa			

Vendi i vërtetimit të urdhërpagesës

--

Formulari numër 7

Vendi për të shtuar informacion dhe logon e ofruesit të shërbimit pagesor

Emërtim i paguesit

Llogaria pagesore e paguesit

[illegible]

Numri tatimor i paguesit

[illegible]

Sqarime shtesë

--

Përshkrimi i pagesës

Shifra

--	--	--	--	--

Data e dorëzimit

Data Engineering							

Data (valuta) e realizimit

--	--	--	--	--	--	--	--

Nënshkrimi i paguesit

**Urdhërpagesë
Transferim kreditor ndaj përdoruesvetë
buxhetit TKB**

Emërtim i pranuesit

--	--

Llogaria pagesore e pranuesit

[illegible]

Shuma

[illegible]

Llogaria e pagesës

[illegible]

Llogaria pagesore e përdoruesve të buxhetit

[illegible]

Shifra e të hyraver dhe programi

--	--	--	--	--	--	--	--

Emri i sistemit pagesor

Vendi për vërtetim të urdhërpagesës

Formulari numër 8

Urdhärpagesë

Transferim kolektiv kreditor TKK

Emri i paguesit

[illegible]

Numri tatimor i paguesit

[illegible]

Sqarime shtesë

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100	101	102	103	104	105	106	107	108	109	110	111	112	113	114	115	116	117	118	119	120	121	122	123	124	125	126	127	128	129	130	131	132	133	134	135	136	137	138	139	140	141	142	143	144	145	146	147	148	149	150	151	152	153	154	155	156	157	158	159	160	161	162	163	164	165	166	167	168	169	170	171	172	173	174	175	176	177	178	179	180	181	182	183	184	185	186	187	188	189	190	191	192	193	194	195	196	197	198	199	200	201	202	203	204	205	206	207	208	209	210	211	212	213	214	215	216	217	218	219	220	221	222	223	224	225	226	227	228	229	230	231	232	233	234	235	236	237	238	239	240	241	242	243	244	245	246	247	248	249	250	251	252	253	254	255	256	257	258	259	260	261	262	263	264	265	266	267	268	269	270	271	272	273	274	275	276	277	278	279	280	281	282	283	284	285	286	287	288	289	290	291	292	293	294	295	296	297	298	299	300	301	302	303	304	305	306	307	308	309	310	311	312	313	314	315	316	317	318	319	320	321	322	323	324	325	326	327	328	329	330	331	332	333	334	335	336	337	338	339	340	341	342	343	344	345	346	347	348	349	350	351	352	353	354	355	356	357	358	359	360	361	362	363	364	365	366	367	368	369	370	371	372	373	374	375	376	377	378	379	380	381	382	383	384	385	386	387	388	389	390	391	392	393	394	395	396	397	398	399	400	401	402	403	404	405	406	407	408	409	410	411	412	413	414	415	416	417	418	419	420	421	422	423	424	425	426	427	428	429	430	431	432	433	434	435	436	437	438	439	440	441	442	443	444	445	446	447	448	449	450	451	452	453	454	455	456	457	458	459	460	461	462	463	464	465	466
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----

Data e dorëzimit

--	--	--	--	--	--	--	--

Data (valuta) e realizimit

--	--	--	--	--	--	--	--

Nënshkrimi i paguesit

--

Llogaria pagesore e paguesit

[illegible]

Shuma

[illegible]**Numri i folios**

Emri i sistemit pagesor

13

Numri total i urdhëresave

Vendi i vërtetimit të urdhërpagesës

Shtojca numër 2

Lista e shifrave dhe përshkrimi i pagesave

Nr.rend.	Klasifikimi	Shifra	Përshkrimi i pagesës	Përkufizimi
1	Borxhi bankar	BKDF	Tërheqja me vonesë e kredisë	Debitorë të caktuar mund të përfitojnë nga mundësia e tërheqjes me vonesë të kredisë, ndërsa kreditori merr përsipër të sigurojë mjete në një kohë të caktuar me kërkesë të debitorit. Në rast të pranimit të detyrimit të tillë, kreditori ka të drejtë të kompensimit.
2	Borxhi bankar	BKFE	Tarifa për kreditë	Tarifa për kredi bankare. Aktiviteti monetar i lidhur me tarifa të caktuara për kredi bankare, përfshirë: a) tarifë për agjentin; b) tarifë për plotësime dhe ndryshime; c) tarifë për shumën e pashfrytëzuar të kredisë ose dëmshpërblimit të mjeteve; ç) tarifë për pëlqimin e lëshuar nga banka; d) tarifë për kostot financiare shtesë; dh) tarifë për pagesën me vonesë të detyrimeve; e) tarifë për menaxhimin e kredisë / për përpunimin e kërkesës; ë) tarifë për bankën e cila i siguron mjetet (ang. fronting bank); f) kompensim për mjetet e garantuara të huamarrjes; g) tarifë për akreditivin.
3	Borxhi bankar	BKFM	Shlyerja e marrëveshjes për kredi	Memorandum për financim të kredisë bankare. Lëvizja neto e fondeve për njoftimin përfundimtar të marrëveshjes për huamarrje, kur është dërguar veçmas nga udhëzimet për njoftimin përfundimtar të marrëveshjes për kredi.

4	Borxhi bankar	BKIP	Interesi i paguar i kredisë bankare	Interesi i llogaritur. Specifikisht për kreditë bankare.
5	Borxhi bankar	BKPP	Pagesë të kryegjësë të kredisë bankare	Pagesë të kryegjësë. Specifikisht për kreditë bankare.
6	Derivatet e bursës	FNET	Shlyerja neto e marrëveshjeve të standardizuara të së ardhmës	Fondet e lidhura me shlyerjet neto të marrëveshjeve të standardizuara të së ardhmës. Për shlyerjet neto të marzhit fillestar dhe të ndryshueshëm nëpërmjet palës së qendrore kontraktuese, shihni kodin SSRM.
7	Derivatet e bursës	FUTR	Marrëveshjet e standardizuara të së ardhmës	Fondet e lidhura me tregtimin me marrëveshje të standardizuara të së ardhmës.
8	Tatime	ESTX	Tatimi mbi trashëgiminë	Transaksioni i referohet pagesës së tatimit të trashëgimisë.
9	Tatime	FWLV	Beneficione për punonjës të huaj	Pagesa e beneficioneve për punonjës të huaj.
10	Tatime	GSTX	Tatim i mallrave dhe shërbimeve	Transaksioni përfaqëson pagesën për blerjen e tatimit të mallrave dhe shërbimeve.
11	Tatime	HSTX	Tatim i hapësirës së posaçme	Transaksioni i referohet pagesës së tatimit të banesave (ang. housing tax).
12	Tatime	INTX	Tatimi mbi të ardhurat	Transaksioni referohet pagesës së tatimit të të ardhurave.
13	Tatime	NITX	Tatim i fitimit neto	Transaksioni i referohet pagesës së tatimit të fitimit neto.
14	Tatime	PTXP	Tatimi mbi pronë	Transaksioni lidhet me pagesën e tatimit të pronës.
15	Tatime	RDTX	Tatime për rrugët	Transaksioni lidhet me pagesën e tatimit për përdorimin e rrugëve.
16	Tatime	TAXR	Kthimi i tatimit	Transaksioni përfaqëson kthimin e tatimit ose detyrimit tatimor të mbipaguar dhe tatimit mbi të ardhurat e paguara tepër.

17	Tatime	TAXS	Pagesë e tatimeve	Transaksioni përfaqëson pagesën e tatimeve.
18	Tatime	VATX	Pagesë e tatimit të vlerës së shtuar	Transaksioni përfaqëson pagesën e tatimit të vlerës së shtuar.
19	Tatime	WHLD	Tatim i mbajtur	Transaksioni i referohet pagesës së tatimit të mbajtur.
20	Operacionet valutore	FORW	Foruard me valutë	Transaksionet për shitblerje të valutave me datë të së ardhmës të valutës.
21	Operacionet valutore	FXNT	Shlyerjet neto të tregtimit me valuta	Shlyerjet neto të tregtimit me valuta.
22	Derivatet në tregjet nëpërmjet sportelit	CDEP	Pagesë në rast të pamundësisë së shlyerjes së detyrimeve	Pagesë në rast të pamundësisë së shlyerjes së detyrimeve (ang. credit default event).
23	Derivatet në tregjet nëpërmjet sportelit	SWFP	Pagesa përfundimtare e marrëveshjes swap	Pagesa përfundimtare e marrëveshjes swap.
24	Derivatet në tregjet nëpërmjet sportelit	SWPP	Pagesa e pjesërishme e marrëveshjes swap	Pagesa e pjesërishme e marrëveshjes swap.
25	Derivatet në tregjet nëpërmjet sportelit	SWRS	Pagesë për ndryshimin e marrëveshjes swap	Pagesë për ndryshimin e marrëveshjes swap.
26	Derivatet në tregjet nëpërmjet sportelit	SWUF	Pagesa paraprake e marrëveshjes swap	Pagesa paraprake e marrëveshjes swap.
27	E-tregtia	ECPG	Pagesë e garantuar	Pagesë nëpërmjet e-tregtisë me garanci të pagesës nga banka emetues.
28	E-tregtia	ECPR	Kthimi i mjeteve nga e-tregtija	Kthimi i mjeteve për pagesa nga e-tregtija
29	E-tregtia	ECPR	Pagesë e pa garantuar	Pagesa nëpërmjet e-tregtisë pa garanci për pagesë nga banka emetuese.
30	E-tregtia	EPAY	E-pagesa	Transaksioni i referohet pagesës elektronike.

31	Shëndetësi	ANTS	Shërbimet e anestezisë	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e anestezisë.
32	Shëndetësi	CVCF	Shërbimet e kujdesit për kujdesin rehabilitues	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e kujdesit rehabilitues
33	Shëndetësi	DMEQ	Pajisje mjekësore të qëndrueshme	Transaksioni përfaqëson pagesën për blerjen e pajisjeve mjekësore të qëndrueshme.
34	Shëndetësi	DNTS	Shërbimet stomatologjike	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet stomatologjike.
35	Shëndetësi	HLTC	Shërbimet e kujdesit shëndetësor për kujdesin në shtëpi të pacientit	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e kujdesit në shtëpi të pacientit
36	Shëndetësi	HLTC	Sigurimi shëndetësor	Transaksioni është pagesë e sigurimit shëndetësor.
37	Shëndetësi	HSPC	Kujdesi spitalor	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e kujdesit spitalor.
38	Shëndetësi	ICRF	Shërbimet e mbrojtjes sociale	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e mbrojtjes sociale
39	Shëndetësi	LTCF	Kujdesi shëndetësor afatgjatë	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e institucionit e kujdesit afatgjatë.
40	Shëndetësi	MAFC	Kontributet në Fondin e Sigurimit Shëndetësor	Transaksioni përfaqëson pagesën e kontributit në Fondin e Sigurimit Shëndetësor.
41	Shëndetësi	MARF	Kthimi i shpenzimeve për ndihmën mjekësore	Transaksioni i referohet kthimit të shpenzimeve të ndihmës mjekësore.
42	Shëndetësi	MDCS	Shërbime shëndetësore	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet shëndetësore.
43	Shëndetësi	VIEW	Shërbimet oftalmologjike	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet oftalmologjike
44	Investime	ANNI	Anuiteti	Transaksioni i referohet pagesës së anuitetit të kredisë, sigurimit, investimeve dhe të tjera.
45	Investime	CAFI	Tarifa e brendshme e menaxhimit të llogarisë së kujdestarit të pronës	Transaksioni i referohet pagesës së tarifës së menaxhimit të llogarisë së kujdestarit të pronës, ku

				banka kujdestare e pronës dhe banka që e mirëmban llogarinë e pagesës, janë në pajtim.
46	Investime	CFDI	Reduktimi i brendshëm i kryegjësë bazë	Transaksioni është pagesë e reduktimit të kryegjësë bazë në rast se banka kujdestare e pronës dhe banka që e mirëmban llogarinë e pagesës, janë në pajtim.
47	Investime	CMDT	Pagesa e mallrave	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e mallrave.
48	Investime	DERI	Derivatet	Transaksioni i referohet tregtimit të derivateve.
49	Investime	DIVD	Dividenti	Transaksioni përfaqëson pagesën për dividendin.
50	Investime	FREX	Shit-blerja e valutave	Transaksioni i referohet operimit në tregun valutor.
51	Investime	HEDG	Sigurimi nga rreziku - hexhing (angl. Hedging)	Transaksioni i referohet operacionit të sigurimit nga rreziku.
52	Investime	INVS	Investime dhe letra me vlerë	Transaksioni i referohet pagesës në mjetet e përbashkëta, produktet e investimit të obligacioneve dhe aksioneve.
53	Investime	PRME	Metale të çmuara	Transaksioni i referohet operimit me metale të çmuara.
54	Investime	SAVG	Kursimet	Transferimi në llogarinë e kursimeve/pensionit.
55	Investime	SECU	Letra me vlerë	Transaksioni përfaqëson pagesën e letrave me vlerë.
56	Investime	SEPI	Blerje interne e letrave me vlerë	Transaksioni paraqet pagesë për blerjen e letrave me vlerë në rast se banka kujdestare e pronës dhe banka që e mirëmban llogarinë e pagesës, janë në pajtueshmëri.
57	Investime	TREA	Pagesa e thesarit	Transaksioni i referohet operacioneve të thesarit.
58	Investime	UNIT	Pagesa në fondin e investimeve	Transaksioni përfaqëson pagesë të fondeve në fondin e investimeve.
59	Pagesat e menjëhershme	IPAY	Pagesat e menjëhershme	Transaksion në të cilin shuma është menjëherë e disponueshme për marrësin.

60	Pagesat e menjëhershme	IPCA	Anulimi i pagesave të menjëhershme	Transaksioni në të cilin kthimi i mjeteve është kthimi i plotë.
61	Pagesat e menjëhershme	IPDO	Pagesa të menjëhershme për donacione	Transaksioni i bërë për donacione, në të cilin shuma është menjëherë në dispozicion të marrësit, duke dërguar të dhënat e adresës të paguesi.
62	Pagesat e menjëhershme	IPEA	Pagesë e menjëhershme në e-tregtinë pa detaje të adresës	Transaksion i bërë në e-tregtinë, në të cilën shuma është menjëherë e disponueshme për marrësin, pa dërguar të dhëna për adresën e paguesit.
63	Pagesat e menjëhershme	IPEA	Pagesë e menjëhershme në e-tregtinë me detaje të adresës	Transaksion i bërë në e-tregtinë, në të cilën shuma është menjëherë e disponueshme për marrësin, duke dërguar të dhëna për adresën e paguesit.
64	Pagesat e menjëhershme	IPEA	Pagesat e menjëhershme në e-tregtinë	Transaksion i bërë në e-tregtinë, në të cilën shuma është menjëherë e disponueshme për marrësin.
65	Pagesat e menjëhershme	IPPS	Pagesë e menjëhershme në pikën e shitjes	Transaksioni në të cilin shuma është menjëherë në dispozicion të marrësit, e realizuar në pajisje terminale në pikën e shitjes.
66	Pagesat e menjëhershme	IPRT	Kthimi i pagesave të menjëhershme	Transaksion për kthim të pjesshëm ose të plotë të shumës së pagesës së menjëhershme.
67	Pagesat e menjëhershme	IPU2	Pagesë e menjëhershme në pajisje me vërtetim me dy faktorë	Pagesa e menjëhershme në makinë shitëse vetë-shërbimi duke përdorur vërtetimin me dy faktorë.
68	Pagesat e menjëhershme	IPUW	Pagesë e menjëhershme në pajisje pa vërtetim me dy faktorë	Pagesa e menjëhershme në makinë shitëse vetë-shërbimi pa përdorur vërtetimin me dy faktorë.
69	Shërbimet publike komunale	CBTV	Fatura e televizionit kabllor	Transaksioni i referohet pagesës së faturës së televizionit kabllor.
70	Shërbimet publike komunale	ELEC	Fatura e energjisë elektrike	Transaksioni i referohet pagesës së faturës së energjisë elektrike.

71	Shërbimet publike komunale	ENRG	Energjia	Transaksioni i referohet pagesës së energjisë.
72	Shërbimet publike komunale	GASB	Fatura e gazit	Transaksioni i referohet pagesës së faturës së gazit.
73	Shërbimet publike komunale	NWCH	Tarifë për rrjetin	Transaksioni i referohet pagesës së tarifave të përdorimit të rrjetit.
74	Shërbimet publike komunale	NWCH	Komunikimi i rrjetit	Transaksioni i referohet pagesës së komunikimit në rrjet.
75	Shërbimet publike komunale	OTLC	Llogaria për shërbime të tjera të telekomunikacionit	Transaksioni i referohet pagesës së faturës së llogarisë për shërbime të tjera të telekomunikacionit
76	Shërbimet publike komunale	PHON	Fatura për telefonin	Transaksioni i referohet pagesës së faturës së telefonit.
77	Shërbimet publike komunale	UBIL	Shërbimet komunale të lidhura	Pagesa të furnizuesi i përbashkët i gazit, ujit dhe/ose energjisë elektrike.
78	Shërbimet publike komunale	WTER	Fatura për ujin	Transaksioni i referohet pagesës së faturës së ujit.
79	Shlyerjet e kartelave	CBLK	Mbledhje e klirimit të kartelës	Shërbim që shlyen mjete monetare të shumës së transaksioneve me kartela, duke iu referuar njëkohësisht një skedari specifik transaksionesh ose informacionesh të tjera si shenjë identifikimi të pajisjes terminale, simbolin e identifikimit të ofruesit të shërbimit të pagesave që pranon kartela ose detaje të tjera të transaksionit.
80	Shlyerjet e kartelave	CDCB	Pagesa me kartela me pagesa të parave të gatshme	Blerja e mallrave dhe shërbimeve me pagesë shtesë të parave të gatshme në pikën e shitjes (ang.: CashBack).
81	Shlyerjet e kartelave	CDCD	Pagesa me para të gatshme me kartelë	Tërheqja e parave në bankomat në mjedis vetëshërbimi ose në mjedis shërbimi (në sportelin e ofruesit të shërbimit të pagesave).

82	Shlyerjet e kartelave	CDCS	Pagesa me para të gatshme me kartelë me tarifë shtesë	Tërheqja e parave në bankomat në mjedis vetëshërbimi ose në mjedis shërbimi (në sportelin e ofruesit të shërbimit të pagesave) me tarifë shtesë.
83	Shlyerjet e kartelave	CDDP	Pagesa e shtyrë me kartelë	Shërbim i kombinuar që lejon ofruesin e shërbimit të pagesave që pranon kartelën të autorizojë shumë të përkohshme dhe të plotësojë shumën përfundimtare brenda periudhës së kufizuar. Pagesa e shtyrë ofrohet vetëm në mjedis të vetëshërbimit. Shembuj se ku përdoret ky shërbim janë pikat e karburantit dhe kabinat telefonike.
84	Shlyerjet e kartelave	CDOC	Miratimi origjinal	Shërbimi që i mundëson pranuesit të kartelës të kreditojë llogarinë e mbajtësit të kartelës. Ndryshe nga kthimi i mjeteve nga tregtari, autorizimi origjinal nuk paraprihet nga pagesë me kartelë. Përdoret për shembull për të kredituar / miratuar fitimet nga lojërat e fatit.
85	Shlyerjet e kartelave	CDQC	Zëvendësimi i parave të gatshme	Blerja e mallrave që janë ekuivalente me para në dorë (angl. Quasi Cash), të tilla si kuponët e kazinosë.
86	Shlyerjet e kartelave	ETUP	Rimbushja e e-portofolit	Transaksioni lidhet me pagesë për shërbim që lejon që mjetet monetare të rezervohen fillimisht nga llogaria me të cilën është lidhur kartela e pagesës, dhe më pas mbushni e-portofolin me këtë shumë.
87	Shlyerjet e kartelave	FCOL	Pagesa e tarifave	Shërbimi që shlyen tarifat që lidhen me transaksionet e pagesave të realizuara me kartela ndërmjet dy palëve.
88	Shlyerjet e kartelave	MTUP	Rimbushje e numrit të përdoruesit celular	Shërbim me të cilin mjetet monetare rezervohen fillimisht nga llogaria me të cilën është lidhur kartela e pagesës, dhe më pas numri i përdoruesit celular plotësohet për atë shumë.

89	Pagesat komerciale	AGRT	Transfertë për bujqësinë	Transaksioni i referohet pagesës në fushën bujqësore.
90	Pagesat komerciale	AREN	Regjistrimi i të arkëtueshmeve	Transaksioni i referohet pagesës në lidhje me regjistrimin e të arkëtueshmeve.
91	Pagesat komerciale	BEXP	Shpenzimet e biznesit	Transaksioni i referohet pagesës së shpenzimeve të biznesit.
92	Pagesat komerciale	BOCE	Regjistrimi i konvertimit në departamentin e zyrës në sfond	Transaksioni i referohet pagesës që lidhet me regjistrimin e konvertimit në departamentin e zyrës në sfond.
93	Pagesat komerciale	COMC	Pagesat komerciale	Transaksioni i referohet pagesës së kredisë tregtare ose borxhit bazuar në produktin e kredisë.
94	Pagesat komerciale	CPYR	Të drejtat e autorit	Transaksioni i referohet pagesës së shpenzimeve të drejtave të autorit.
95	Pagesat komerciale	GDDS	Shit-blerja e mallrave	Transaksioni i referohet blerjes dhe shitjes së mallrave.
96	Pagesat komerciale	GDSV	Shit-blerja e mallrave dhe shërbimeve	Transaksioni i referohet blerjes dhe shitjes së mallrave dhe shërbimeve.
97	Pagesat komerciale	GSCB	Shit-blerja e mallrave dhe shërbimeve duke paguar me para të gatshme	Transaksioni i referohet blerjes dhe shitjes së mallrave dhe shërbimeve duke paguar me para të gatshme (angl. CashBack).
98	Pagesat komerciale	LICF	Tarifë për licencë	Transaksioni përfaqëson pagesën për shërbimet e licencës.
99	Pagesat komerciale	MP2B	Pagesat celulare nga personi fizik ndaj subjektit biznesor (P2B).	Shërbimi që lejon përdoruesin të kryejë transaksion pagesë duke përdorur aplikacion në telefonin e tij celular për të paguar shitësin ose marrësin tjetër të biznesit. Informacioni i llogarisë ose identifikimi i marrësit i transmetohet aplikacionit nëpërmjet kanaleve të ndryshme, për shembull, QR kodin (QR code), NFC-në, blututhin (Bluetooth), rrjete të tjera.

100	Pagesat komerciale	POPE	Regjistrimi në pikën e shitjes	Transaksioni i referohet pagesës në pikën e shitjes.
101	Pagesat komerciale	ROYA	Të hyra nga pagesa për përdorimin e pronës	Transaksioni i referohet pagesës në bazë të përdorimit të pronës (angl. royalties).
102	Pagesat komerciale	SCVE	Shit-blerja e shërbimeve	Transaksioni i referohet blerjes dhe shitjes së shërbimeve.
103	Pagesat komerciale	SERV	Tarifë për shërbime	Transaksioni i referohet pagesave për shërbimet që i paguan ofruesi i shërbimit.
104	Pagesat komerciale	SUBS	Parapagim	Transaksioni i referohet pagesave të shërbimit informativ ose argëtues qoftë në formë letrë apo elektronike.
105	Pagesat komerciale	SUPP	Pagesat e furnizuesit	Transaksioni i referohet pagesës së furnizuesit.
106	Pagesat komerciale	TRAD	Shërbimet tregtare	Transaksioni i referohet pagesës së shërbimeve tregtare.
107	Kompensimi	B112	Kompensimi i shitësit të fondit të përbashkët	Kompensimi (12b-1) për shitësin kur shet asetet në fonde të përbashkëta.
108	Kompensimi	BR12	Zbritja e shitësit të fondit të përbashkët.	Zbritja e shitësit të fondit të përbashkët.
109	Kompensimi	TLRF	Kompensimi i shitësit të fondit të përbashkët (jashtë nga ShBA-ja)	Çdo kompensim nga menaxheri i fondit të përbashkët ndaj shitësit të fondit të përbashkët që nuk është nga ShBA-ja. Përdoret kodi ndërkombëtar për identifikimin e letrave me vlerë (angl. ISIN - International Securities Identification Code).
110	Kompensimi	TLRF	Rabati i shitësit të fondit të përbashkët (jashtë nga ShBA-ja)	Çdo rabat nga menaxheri i fondit të përbashkët ndaj shitësit të fondit të përbashkët, e cila nuk është nga ShBA-ja. Përdoret kodi ndërkombëtar për identifikimin e letrave me vlerë (angl. ISIN - International Securities Identification Code).

111	Kolaterali	BFWD	Forvardi i bondeve	Kolaterali në para të gatshme lidhur me transaksion të ardhshëm me letra me vlerë, me maturim më shumë se tri ditë, ku përfshihen bonot e thesarit.
112	Kolaterali	CCIR	Shkëmbimi i normave të interesit në valuta të ndryshme	Kolaterali në para i lidhur me shkëmbim normash interesi në valuta të ndryshme, ku pagesat e interesit fiks në valutë shkëmbehen me pagesat e interesit në valutë tjetër.
113	Kolaterali	CCPC	Pastrimi i marzhit fillestar me palë kontraktuese qendrore	Siguria monetare në lidhje me kontratën ISDA (angl. ISDA - International Swaps and Derivatives Association) ose marrëveshjen qendrore të kleringut, i cili mbulon kërkesat fillestare të marzhit për qëllimin e kleringut të transaksioneve të kryera në tregjet nëpërmjet sportelit që shlyhen nëpërmjet palës qendrore.
114	Kolaterali	CCPC	Pastrimi i marzhit variabil te pala kontraktuese qendrore	Siguria monetare në lidhje me kontratën ISDA (angl. ISDA - International Swaps and Derivatives Association) ose marrëveshjen qendrore të kleringut, i cili mbulon kërkesat për variablën e marzhit për qëllimin e kleringut të transaksioneve të kryera në tregjet nëpërmjet sportelit që shlyhen nëpërmjet palës qendrore.
115	Kolaterali	CCSM	Pastrimi i marzhit fillestar të alokuar te pala kontraktuese qendrore	Marzhi variabil te pala kontraktuese qendrore: Marzhi fillestar për derivatet e tregjeve përtej sportelit u realizua kliring nëpërmjet palës kontraktuese qendrore që kërkon ndarjen e marzhit.
116	Kolaterali	CRDS	Shkëmbimi i rrezikut kreditor	Transaksioni përfaqëson kolateralin në para për transaksionet e shkëmbimit të rrezikut të kredisë (angl. këmbimi i parazgjedhjes së kredisë).

117	Kolaterali	CRPR	Produkt i kryqëzuar	Kolaterali në para në lidhje me lloje të ndryshme të tregtisë.
118	Kolaterali	CRSP	Mbështetje kreditore	Sigurimi monetar në lidhje me dhënien / marrjen e parave në hua; letër krediti; nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.
119	Kolaterali	CRTL	Linja e kreditit	Kolaterali në para i lidhur me hapjen e linjës së kreditit përpara tregtimit.
120	Kolaterali	EQPT	Opsionet me aksionet	Kolaterali në para i lidhur me tregtimin e opsioneve të aksioneve.
121	Kolaterali	EQUUS	Shkëmbimi i aksioneve	Kolaterali në para i lidhur me tregtimin e këmbimit të aksioneve, ku kthimi i aksioneve zëvendësohet me normë interesi fikse ose të ndryshueshme.
122	Kolaterali	EXPT	Opsioni ekzotik	Kolaterali në para i lidhur me tregtimin e opsioneve ekzotike, p.sh. opsione jo standarde.
123	Kolaterali	EXTD	Derivatet e tregtuara në treg të organizuar	Kolaterali në para në lidhje me tregtimin e derivativëve të standardizuar në treg të organizuar (në krahasim me tregun nëpërmjet sportelit).
124	Kolaterali	FIXI	Investime me të ardhura fikse	Kolaterali monetar i lidhur me instrumentet financiare me të ardhura fikse/norma e kthimit (p.sh. obligacione).
125	Kolaterali	FWBC	Kolaterali në para për ndërmjetësin në transaksionet e ardhshme	Transaksioni përfaqëson një pagesë të kolateralit monetar ndaj ndërmjetësit sipas kontratës së ardhshme kornizë, ku fondet mbahen në një llogari të veçantë dhe nuk janë të disponueshme për klientin. Shifra për të gjitha instrumentet me datë të shlyerjes (së ardhshme), të tilla si transaksionet që do të shpallen (TBA), marrëveshjet e riblerjes (repos) dhe transfertat e obligacioneve.

126	Kolaterali	FWCC	Kolaterali në para për klientin në transaksionet e ardhshme	Transaksioni përfaqëson pagesën e kolateralit në para për klient sipas kontratës së ardhshme kornizë, u fondet janë në pronësi dhe në dispozicion të klientit pas përfundimit. Kodi për të gjitha instrumentet në datën e shlyerjes, siç janë transaksionet e letrave me vlerë të mbështetura me hipotekë, që do të publikohen (angl. To Be announced – TBA), marrëveshjet e riblerjes (repo) dhe të obligacioneve të ardhshme.
127	Kolaterali	FWSB	Sigurim i veçantë në para për ndërmjetësin në transaksionet e ardhshme	Të gjitha mjetet për ndërmjetësin e sigurisë (garanci, sigurim) sipas kontratës së ardhshme kornizë, të cilat janë lënë mënjanë dhe nuk janë në dispozicion të klientit. Shembulli i kontratës së ardhshme kornizë përfshin transaksione me letra me vlerë të mbështetura nga hipoteka që duhen shpalosur (angl. To Be announced – TBA), marrëveshjet e riblerjes (repo) dhe të obligacioneve të ardhshme.
128	Kolaterali	FWSB	Sigurim i veçantë në para për klientët në transaksionet e ardhshme	Të gjitha mjetet monetare për sigurinë (garanci, sigurim) sipas kontratës së ardhshme kornizë, të cilat janë në pronësi të klientit dhe janë në dispozicion të klientit pas kthimit nga llogaria e veçuar. Shembulli i kontratës së ardhshme kornizë përfshin transaksione me letra me vlerë të mbështetura nga hipoteka që duhen shpalosur (angl. To Be announced – TBA), marrëveshjet e riblerjes (repo) dhe të obligacioneve të ardhshme.

129	Kolaterali	MARF	Marzhi ditor për derivatet e kuotuar	Marzhi ditor i rënë dakord mbi derivatet. Shembuj janë pagesat e marzhit për të ardhmen dhe opsionet e kuotuar, primet për opsionet e kuotuar që nuk mbulohen nga porositë MT54X.
